**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0027425/24 dt. 22.04.2024**
**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **martën** më dt. **30.04.2024**:

**T H Ë R R E T**
**Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës**
**Seanca e 31-të**

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale
3. Raport financiar për periudhën janar-mars 2024
4. Pyetje dhe përgjigje

**Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.**

**Mitrovicë**

**Kryesuesja e Kuvendit**
**Vesa BROJA**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0022173-1/24 dt. 08.04.2024**
**Mitrovicë**

# P R O C E S V E R B A L
## Nga mbledhja e 30-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

**Koha:** 08.04.2024 ora 10:00
**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahimi, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Hamdi Hasani, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Nafije Rexha, Faruk Mujka, Hysen Muzliukaj, Kushtrim Zeneli, Jeton Zeneli, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Shkurta Shosholli Musa, Muhamed Hoti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri, Ardita Aliu

**Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri**
**Drejtorët e Drejtorive**
**Përfaqësues të Shoqërisë Civile**
**Mediat**

**Mungoi:** Lavdim Zeneli, Mentor Vinarci, Naser Muja, Erseka Barani, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Xhyljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj**,** Sevdaim Uka, Gazmend Asllani, Oltion Ahmeti, Gjergj Beka

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 30-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se me email ju ka ardhur Propozim-vendimi për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale", i cili propozohet të hyjë në rend dite si pikë e 5-të e rendit të ditës.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Hysen Muzliukaj: Në mbledhjen e kaluar ka qenë në rend dite Raporti i punës së Drejtorisë për Shëndetësi për periudhën janar-dhjetor 2023, i njëjti nuk është diskutuar në atë mbledhje, andaj kjo pikë është dashur të jetë në rend dite sot, ka qenë praktikë që pikat që kanë mbetur pa u diskutuar të sillen në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Fahri Shabani: Raporti i DSH-së me kohë është dorëzuar në Sekretarinë e Kuvendit, ka qenë në rend të ditës në mbledhjen e KPF-së ku edhe është miratuar dhe proceduar në Kuvend për shqyrtim, po ashtu në Kuvend në seancën e fundit të KK-së ka qenë në rend dite por nuk është diskutuar, nëse e kërkoni do ta sjellë në mbledhjen e radhës.

Kushtrim Zeneli: Në mbledhjen e kaluar e ngrita një çështja dhe pata një propozim konkret, njëra prej tyre ka qenë subvencionimi në çerdhet private dhe lirimi nga pagesa në çerdhet publike për nënat vetushqyese. Gjatë diskutimeve na u tha se është një udhëzim administrativ që i liron disa kategori, e aty bëjnë pjesë edhe nënat vetushqyese dhe u tha se na duhet të kemi një raport më të theksuar dhe më të detajuar në seancën e ardhshme prej DMS-së, sot nuk e kemi këtë raport në rend dite, prandaj për seancën e radhës përveç Raportit të DSH-së në rend dite ta kemi edhe Raportin e DMS-së që ta dimë saktë sa fëmijë janë në çerdhet publike, sa në çerdhet private, me qëllim që të marrim një vendim për këto kategori, unë jam shumë i interesuar që të marrim vendimin e duhur për këtë kategori.

Vesa Broja: Pikat që u cekën nga z. Muzliukaj dhe z. Zeneli do të sillen për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim propozimin që pikë e 5-të e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Qendra Multifunksionale”.

**Kuvendi i Komunës unanimisht (21-për, 0 kundër dhe 0 abstenime) miratoi propozimin që pikë e 5-të e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Qendra Multifunksionale”**.

**Kryesuesja në vazhdim vuri në votim këtë rend dite:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale
3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës
4. Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare
5. Propozim-vendim për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Qendra Multifunksionale”
6. Pyetje dhe përgjigje

**Rezultati i votimit 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime**.
**Rendi i ditës u miratua unanimisht.**

## Pika 1

**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (21-për, 0 kundër dhe 0 abstenime)**.

## Pika 2

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.

Florina Çitaku: Kam disa propozime lidhur me taksat për dëmtime të rrugëve, asfaltit, kubëzave etj. Besoj se taksat për këto dëmtime duhet të jenë më rigoroze. Te tabela Nr. 10 - Taksa komunale për bllokimin e rrugëve primare dhe sekondare, pika 2, Bllokimi i rrugës primare nga personat fizik nga gjashtë deri në dymbëdhjetë orë, taksa prej 50 € duhet të ngritët në 100 €, po ashtu edhe te tabela Nr. 11 – taksat për dëmtim të asfaltit, zhavorrit, kubëzave të betonit, rrugëve me zhavorr, janë taksa të ulta, edhe këtu propozoj të ngritën këto taksa sepse po u krijojmë hapësirë

që kushdo të dëmtoj asfaltet dhe rrugët e rregulluara dhe të riparuara dhe të ketë një taksë simbolike, prandaj prapë po e përsëris që këto gjoba duhet të jenë më të larta. Po ashtu kjo draft-rregullore duhet të korrektohet në aspektin gjuhësor.

Faruk Mujka: Kuvendi i Komunës pat formuar një Komision për hartimin e kësaj draft-rregulloreje, përnjëherë ky komision është zëvendësuar me një komision prej Kryetarit të Komunës, nuk ka qenë praktikë që për një draft-rregullore të kemi dy komisione, një nga Kuvendi e një nga ekzekutivi, prandaj është e mundur të dalin këso telashe dhe ky mos komunikim, e drejta për plotësim-ndryshim të rregullores ose duhet t'i kthehet anëtarëve të Kuvendit, ose krejt kompetencat për këtë çështje t'i barten ekzekutivit, sepse versioni final i hartuar nga Komisioni i Kuvendit me versionin final të hartuar nga Komisioni i Kryetarit ka pakë të përbashkëta. Po ashtu ne si Kuvend kemi marrë vendim për ngritjen e taksës për ata që dëmtojnë asfaltin, kubëzat apo rrugët, dhe komuna të merret me këtë punë e jo t'u lihet atyre sepse të njëjtit kurrë nuk i kanë rregulluar.

Igballe Islami: Kryetari i Komunës ka formuar Komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj draft-rregulloreje, draft-rregullorja e plotësuar i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore për të ardhur për shqyrtim dhe miratim, kemi raportin nga diskutimi publik, kemi konfirmimin e ZKF-së për implikimin financiar, kemi konfirmimin e Zyrës ligjore, e njëjta i është nënshtruar edhe korrekturës, prandaj e kompletuar ka ardhur për miratim në Kuvend.

Granit Tmava: Taksat që u cekën nga znj. Çitaku nuk kanë të bëjnë vetëm për një pozicion, fjala është për $m^2$ për secilin pozicion veç e veç, siç janë cekur edhe në tabela, qëllimi është që me këto taksa të gjenerojmë të hyra dhe rrugët e dëmtuara qofshin me gërmime, prerje, kyçje etj., të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Hysen Muzliukaj: E pashë konfirmimin prej ZKF-së, mirëpo nuk ceket se sa është vlera e implikimeve financiare, është thënë që ka ndikim pozitiv, a ka mundur ta përcaktoj sa, a ka ndonjë matje, në bazë të raporteve vjetore mund të nxirret mesatarja.

Igballe Islami: Edhe unë gjatë kthimit të kësaj përgjigjeje kam insistuar me qenë një vlerë e parallogaritur, mirëpo siç e dini kjo është një taksë, ne nuk mund ta dimë se sa kërkesa do të kemi qoftë për prerje të asfaltit, qoftë për leje ndërtimore dhe të tjera, prandaj për këtë arsye ZKF-ja nuk ka mundur të nxjerrë një vlerë parallogaritare, prandaj në pikat ku kemi ngritje të taksës, tarifës do të kemi implikime pozitive të buxhetit në të hyrat e Mitrovicës, ndërsa në të kundërtën do të ketë implikime negative në të hyrat e Mitrovicës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.

**Rezultati i votimit 20 për, 1 kundër dhe 0 abstenime**.

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar me shumicë votash Draft-Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2019 Për taksa, tarifa dhe gjoba komunale**.

**Pika 3**

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: Të hyrat e bartura nga viti i kaluar janë të mirëseardhura për shkak se 329.000 € janë tejkalim i planit. Ajo çka kemi pritur dhe ka qenë praktikë edhe në vitet e mëhershme, është shuma prej 1.000.000 € mjete të pashpenzuara që kanë qenë në dispozicion, ndërsa tash me modelin e ri është vështirësuar goxha shumë sepse ekzekutivi e ka në dispozicion vetëm vlerën prej 329.000 €, që janë selektuar, pra janë ndarë nëpër kode, prandaj për vitin e ardhshëm ekzekutivi duhet të jetë shumë më i kujdesshëm te planifikimi i projekteve, sepse nëse vazhdohet

me modelin e ri, nëse një projekt e parasheh me u realizuar brenda vitit, dhe nëse nuk starton ai projekt, dështon, mjetet njërën anë bllokohen dhe në anën tjetër shuma e cila tejkalohet nuk të jep mundësi me zhvilluar procedura te projektet tjera. Sipas parashikimit që e bëra, prej shumës së mbetur ka mundësi të merren vetëm 329.000 € dhe të selektohen në projektet në vlerë deri në 30% të projektit, ndërsa pjesa tjetër për momentin mbetet e ngrirë, sipas një parallogarie që e bëra diku 400.000 € kanë me mbetur të ngrira. Mezi pata pritur të vije kjo pikë dhe kjo pjesë e mbetur e mjeteve të kërkoj të selektohen në tri projekte, projekti i parë te Liqeni, të ndahen mjete shtesë për këtë aset dhe ta shfrytëzojmë, të tërhiqen vizitorë edhe nga komunat tjera, të mbahet gjelbërimi, pastërtia, rregulli, sepse kemi një vlerë të re dhe indirekt ndikon edhe në të hyrat e Komunës. Projekti i dytë që kam menduar të ndahen mjete është çështja e kontratës kornizë e ujërave të zeza, që po neglizhohet prej viti në vit, jemi në hall, është tepër e domosdoshme dhe kam pritur që një pjesë e këtyre mjeteve do të ndahen për këtë qëllim dhe të fillohet në disa zona. Ndërsa projekti i tretë që kam menduar të fillohet të punohet është pjesa qendra, te Banka Ekonomike, në ekzekutivin e kaluar ka qenë obligim i operatorit ta ndërtojë një zonë të gjelbër aty dhe lojëra për fëmijë, ndërsa në bazë të informatave që kemi marrë kjo pjesë nuk është përfshirë në kontratë, prandaj ajo pjesë duhet sa më shpejtë të rregullohet sepse po i jep një pamje jo të mirë qytetit.

Faruk Mujka: Sa i përket bartjes së të hyrave kjo është çështje interne e ekzekutivit, pse kanë tepruar 1.000.000 €, edhe kjo është çështje e ekzekutivit, ndërsa nëse duhet të diskutojmë për prioritetet unë pajtohem me të gjitha prioritetet që i ceku z. Veseli.

Nafije Rexha: Edhe unë pajtohem me propozimet e z. Veseli, mirëpo sa i përket propozimit të tretë unë më shumë mendoj që këto mjete të barten në arsim, sepse ka nevojë për renovime të shumta, dhe unë kisha dëshiruar se sa herë ka tepricë të mjeteve financiare çdo herë arsimin ta keni prioritet.

Jeton Ujkani: Po e ngris një çështje të cilën e kam ngritur 2-3 herë, fjala është për varrezat e fshatit Vinarc, në ato varreza nuk ka vend për asnjë të vdekur, banorët e fshatit e kanë ndarë parcelën, e kanë dhuruar për këtë qëllim, nevojitet vetëm një investim për rrethojën dhe kubëzimin, pra fjala është për 30.000 €, kërkoj që ky investim të bëhet me këtë bartje të mjeteve financiare.

Igballe Islami: Me bartjen e të hyrave vetanake për këtë vit nuk ka mundësi sepse me rregulla e reja bartja e këtyre mjeteve do të bëhet vetëm në projektet që kanë qenë të planifikuara.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës.

**Rezultati i votimit 23 për, 0 kundër dhe 0 abstenime**.

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës**.

**Pika 4**

Kryesuesja e Kuvendit hapi diskutimin lidhur me Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Florina Çitaku: Parimisht jam pro çdo iniciative për ngritje profesionale të nëpunësve të Komunës, mirëpo obligim i ynë është që të jemi të kujdesshëm për shpenzimin e parasë publike, prandaj e shoh të arsyeshme të kemi edhe disa sqarime shtesë, sepse kërkesa nga Sindikata është paraqitur në vija të trasha, Sindikata a ka pasur paraprakisht kontakte me përfaqësuesit e institucioneve ku do të bëhen këto vizita, sepse nuk është specifikuar, nuk ka ftesa, dhe rrjedhimisht lind pyetja se mbi cilët parametra është caktuar shuma prej 5.000 €, sa nëpunës civil do të shkojnë, cilët nëpunës do të shkojnë, a do të shkojnë shefa sektorësh, drejtorë apo kush do të shkojë, pra kemi nevojë për sqarime shtesë.

Faruk Mujka: E kam lexuar kërkesën në fjalë, me gjithë respektin edhe për sindikatën edhe për kryesinë, kërkesë më të paqartë nuk kam lexuar asnjëherë, çështja e trajnimeve, çështja e

ngritjes profesionale të nëpunësve civil nuk është çështje e sindikatës, kjo është çështje e secilës drejtori veç e veç, dhe këto mjetet janë të parapara me buxhet.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

**Rezultati i votimit 11 për, 0 kundër dhe 0 abstenime**.

**Kryesuesja konstatoi se nuk miratohet Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare**.

**Pika 5**

Kryesuesja e Kuvendit para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale", theksoi se me këtë propozim-vendim propozohet të ndryshohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3, dt. 31.01.2022 për Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale", dhe atë paragrafi 3, i nenit 1, të këtij Vendimi, ku në vend të anëtares së Komisionit - znj. Valdete Idrizi, si anëtare e re e këtij Komisioni të emërohet - znj. Drita Kadriu.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale".

**Rezultati i votimit 23 për, 0 kundër dhe 0 abstenime**.

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-3 dt. 31.01.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale"**.

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:15 min.**

| | | |
|---|---|---|
| **Mitrovicë** | **Procesmbajtës:** | **Kryesuesja e Kuvendit** |
| | ________________ | ________________ |
| | **Merita PRETENI** | **Vesa BROJA** |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **22.04.2024** |
| **REFERENC-Ë:** | 02-400/01-0027518/24 |
| **PËR/ZA/TO:** | **znj. Vesa BROJA, Kryesuese e Kuvendit** |
| **KOPJE :** | **Arkivit** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **z. Bedri HAMZA** - Kryetari i Komunës |
| **NGA/OD/FROM:** | **znj. Igballe ISLAMI -** Drejtore për Buxhet dhe Financa |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale |

E nderuar,

Organizata buxhetore (642) - Komuna e Mitrovices, duke u mbeshtetur ne nenin 30 të L.M.F.P.P si dhe Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 08/L-260 për vitin 2024, bazuar edhe në instruksionet e dhëna të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve , Departamenti i Buxhetit për respektimin e metodologjisë së transferit.

*Të bashkëngjitur gjeni tabelat per transfer dhe rialokim.*

Me respekt,

Kerkojmë që të bëhet transferi i mjeteve në kategorinë e Shpenzime Kapitale nga fondi burimor i Grantit (10) për programet/nënprogramet të ndikura negativisht nga projektet :

- Nga 10/642/85022/300/54681/0820 – Shërbimt Kulturore, projekti "Rritja e kapacitetit të ulëseve në Palestrën Sportive" në shumë prej (30,000.00) €
- Nga 10/642/92110/30/53082/0980- Administrata e Arsimit, projekti " Rregullimi i objektit Gjimnazi Frang Bardhi dhe SHMLE Hasan Prishtina" ne shumen prej (40,000.00) €.

Të transferohen në programet / nënprogramet të ndikuara pozitivisht gjegjësisht në projektet:

- Ne 10/642/48022/300/48532/0411 , projekti "Rregullimi,riparimi i rrugës Mbretëreshë Teutë" shuma e transferuar 70,000.00 €

Kerkojmë që të bëhet transferi i mjeteve në kategorinë e Shpenzime Kapitale nga fondi burimor i THV (22) për programet/nënprogramet të ndikura negativisht nga projektet :

- Nga 22/642/73031/300/53430/0760 - Administrata, projekti "Rregullimi i Objektit per persona me të pamë të dobësuar" në shumë prej (20,000.00) €

Të transferohen në programet / nënprogramet të ndikuara pozitivisht gjegjësisht në projektet:

- Ne 22/642/48022/300/53396/0411 , projekti "Rregullimi i trotuareve me kubëza betoni në qytet, Koshtovë,Zhabar, Vinarci dhe tek Liqeni Akumulues " shuma e transferuar 20,000.00 €

Kërkojm RiAlokimin e mjeteve në kategorinë e Shpenzime Kapitale nga fondi burimor Granti (10) nga programi/nënprogrami i ndikur negativisht si ne vijim :

- Nga 10/642/48022/300/54785/0411- Zhvillimi Ekonomik, projekti "Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Shalë të Bajgorës, Koshtovë, Broboniq, Zhabar, Iliridë, Shipol,Qendër, Bajr,Iliridë,Suhodoll,Lushtë" ne shume prej (40,000.00) €
- Nga 10/642/48022/300/52992/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Rregullimi i Bulevardit Isa Boletini" ne shumen prej (70,000.00) €
- Nga 10/642/48022/300/52617/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugës Dëshmorët e Kombit-Shipol " ne shumen prej (100,000.00) €
- Nga 10/642/48022/300/45889/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vaganicë" ne shumen prej (30,000.00) €
- Nga 10/642/48022/300/45909/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Vllahi" ne shumen prej (20,000.00) €
- Nga 10/642/48022/300/52948/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugëve në Lagjen Ura e Gjakut" ne shumen prej (30,000.00) €
- Nga 10/642/48022/300/51935/0411 - Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugës Lah Nimani dhe Evlia Qelebia" ne shume prej (100,000.00) €
- Nga 10/642/92110/300/53082/0980 - Administrata e Arsimit, projekti " Rregullimi i objektit Gjimnazi Frang Bardhi dhe SHMLE Hasan Prishtina" ne shumen prej (110,000.00) €.
- Nga 10/642/73031/300/54831/0760 – Administrata e Shëndetësisë projekti "Ndërtimi i QMF-së Iliridë" në shumën prej (27,600.00) €

Të ri-alokohen në programin / nënprogramin të ndikuara pozitivisht gjegjësisht në projektin:

- Ne 10/642/73031/300/54724/0760 Administrata e Shendetesise, projektin "Rregullimi i objekteve shëndëtësore QMF Zhabar,QMF-Bare, AMF-Bajgorë,QMF-Bair1 dhe 2,QMF-Fidanishte " te ri-alokohet ne shumën 27,600.00 €.
- Ne 10/642/92110/300/53963/0980 Administrata e Arsimitt, projektin " Ndërtimi i Cerdhes për fëmijë-Shipol" të ri-alokohet në shumën 110,000 €.

- Ne 10/642/48022/300/48532/0411 , projekti "Rregullimi,riparimi i rrugës Mbretëreshë Teutë" shuma e transferuar 95,000.00 €
- Ne 10/642/48022/300/51733/0411 , projekti "Ndërtimi i Urës tek Liqeni Artificial" shuma e transferuar 60,000.00 €
- Në 10/642/48022/300/52963/0411 – Zhvillim Ekonomik, projekti "Asfaltimi i rrugës Agim Ramadani dhe Bislim Bajgora " ne shumen prej (93,818.00)€
- Në 10/642/48022/300/51938/0411 – Zhvillim Ekonomik, projekti "Rregullimi i shtratit të Lumit Ibër" ne shumen prej (88,000.00)€
- Në 10/642/48022/300/53381/0411 – Zhvillim Ekonomik, projekti " Blerja e semaforave, paisjeve sinjalizuese dhe ndriquese në Shipol,Zhabar,Iliridë, Qendër,2Korrik dhe Bajr në shumën prej (53,182.00)€

Kërkojm RiAlokimin e mjeteve në kategorinë e Shpenzime Kapitale nga fondi burimor Granti (22) nga programi/nënprogrami i ndikur negativisht si ne vijim :

- Nga 22/642/48022/300/52301/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugës Mazhiq-Tërrstenë ne shume prej (6,181.15) €
- Nga 22/642/48022/300/52921/0411 – Zhvillimi Ekonomik, projekti "Ndërtimi i rrugëve në Lagjen Ilirida" ne shumen prej (150,000.00) €
- Nga 22/642/73031/300/52949/0760 – Administrata e Shëndetësisë projekti "Ndërtimi i QMF ë Koshtovë Faza II" në shumën prej (610.31) €

Të ri-alokohen në programin / nënprogramin të ndikuara pozitivisht gjegjësisht në projektet:

- Në 22/642/48022/300/52963/0411 – Zhvillim Ekonomik, projekti "Asfaltimi i rrugës Agim Ramadani dhe Bislim Bajgora " ne shumen prej (156,181.15) €
- Ne 22/642/73031/300/54724/0760 Administrata e Shendetesise, projektin "Rregullimi i objekteve shëndëtësore QMF Zhabar,QMF-Bare, AMF-Bajgorë,QMF-Bair1 dhe 2,QMF-Fidanishte " te ri-alokohet ne shumën 610.31 €.

Me respekt,

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **15.04.2024** |
| **REFERENC-Ë:** | 02-400/01-0026155/24 |
| **PËR/ZA/TO:** | **Komitetin për Politike dhe Financa**<br>**z. Vesa BROJA** – Kryesuese e Kuvendit |
| **KOPJE :** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Bedri HAMZA** – Kryetar i Komunës së Mitrovicës |
| **NGA/OD/FROM:** | **Igballe ISLAMI** - Drejtore për Buxhet dhe Financa |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Raporti Financiar Janar Mars 2024** |

E nderuar,

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në kuadër të përpjekjeve për transparencë, respektim të legjislacionit dhe bashkëpunim me Anëtarët e Kuvendit ju prezanton:

**RAPORTIN FINANCIAR TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR PERIUDHËN JANAR – MARS TË VITIT 2024**

Si gjithmonë ne do të jemi të gatshëm në bashkëpunim për të ofruar ndihmë dhe përkrahje në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që kemi si Drejtori.

***Me respekt,***

# Republika e Kosovës
*Republika Kosova – Republic of Kosovo*

# Komuna e Mitrovicës
*Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica*

# RAPORT FINANCIAR

**PËR REALIZIMIN E BUXHETIT KOMUNAL**

**JANAR – MARS**

**2024**

https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/

# PËRMBAJTJA

HYRJE ..... 3
1. TË HYRAT VETANAKE ..... 4
1.1 Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale ..... 4
1.2 Krahasimi i inkasimit të të Hyrave Vetanake me Planifikimin sipas Drejtorive ..... 4
2. BUXHETI DHE SHPENZIMET ..... 5
2.1 Shpalosja e Buxhetit ..... 5
2.2 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave ..... 6
2.3 Paga dhe shtesa ..... 7
2.4 Mallra dhe sherbime ..... 7
2.5 Shpenzime Komunale ..... 8
2.6 Subvencione dhe transfere ..... 9
2.7 Investime Kapitale ..... 9
3. Shpalosja e shpenzimeve sipas programeve/nëprogrameve në kategori ekonomike ..... 10
3.1 Paraqitja grafike e shpenzimeve të buxhetit sipas programeve/nënprogrameve buxhetore ..... 14
3.2 Shpalosja e shpenzimeve në Investime Kapitale ..... 15
4. OBLIGIMET E PAPAGUARA (BORXHET) ..... 20
5. LËNDËT E EKZEKUTUARA NGA MINISTRIA E FINANCAVE – DEPARTAMENTI I THESARIT ..... 20

# HYRJE

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit - LMFPP-së[1] neni 45 paragrafi 4, kryetari i komunës është i obliguar të përgatisë dhe t`i dorëzojë kuvendit raporte periodike dhe vjetore financiare, të cilat mbulojnë vitin fiskal. Pastaj në këtë kontekst raporti duhet të publikohet nga kryetari i komunës në webfaqen zyrtare të komunës dhe një kopje ti dorëzohet Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere pas përfundimit të çdo tre mujori.
Qëllimi i këtij Raporti është që të njoftoi Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediat (elektronike dhe të shkruara) si dhe qytetarët e komunës së Mitrovicës për ekzekutim të buxhetit komunal**.**
Buxheti fillestar i Komunës për vitin 2024 nënkupton LIGJIN NR. 08/L-260 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2024**.**

Sipas mendimit tonë, raporti financiar paraqet një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për periudhen raportuese të institucionit Komuna e Mitrovicës

Si gjithmonë, ne e mirëpresim komentet dhe sygjerimet tuaja të cilat do kontribonin pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së raportimeve periodike në të ardhmën.

---

[1] Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

# 1. TË HYRAT VETANAKE

## *1.1 Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale*

- Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2023 është në shumën prej 3,288,174.00 Euro sipas LIGJIT NR. 08/L-260 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2024.

**Shenim:** Dënimet në trafik, Gjobat e Gjykatave dhe të hyrat nga Agjensioni i Pyjeve nuk inkasohen direkt nga Komuna dhe institucionet nën menaxhimin e saj.

## *1.2 Krahasimi i inkasimit të të Hyrave Vetanake me Planifikimin sipas Drejtorive*

| | Drejtoria | Realizimi - 2024 | Plani 2024 | % inkasimit të Planit Vjetor |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Administrata | 19,450.01 | 102,000.00 | 19.07% |
| 2 | Integrimet Evropiane | 2,500.00 | 50,000.00 | 5.00% |
| 3 | Inspeksioni | 2,675.00 | 15,000.00 | 17.83% |
| 4 | Buxhet dhe Financa | 270,149.54 | 1,368,019.00 | 19.75% |
| 5 | Bujqësia | 1,515.00 | 6,050.00 | 25.04% |
| 6 | Pylltari dhe Inspeksion | 2,856.13 | 72,000.00 | 3.97% |
| 7 | Zhvillimi Ekonomik | 5,065.00 | 30,000.00 | 16.88% |
| 8 | Gjeodezi dhe Kadastër | 71,938.96 | 330,000.00 | 21.80% |
| 9 | Urbanizmi | 40,638.23 | 1,119,105.00 | 3.63% |
| 10 | Sherbimet Sociale | 607.00 | 7,000.00 | 8.67% |
| 11 | Sherbimet Kulturore | 216.00 | 4,000.00 | 5.40% |
| 12 | Sherbimet e Kujdesit Primar | 6,244.00 | 30,000.00 | 20.81% |
| 13 | Çerdhja e Fëmijëve | 27,557.00 | 73,000.00 | 37.75% |
| 14 | SHMT Arkitekt Sinani | 13,423.00 | 40,000.00 | 33.56% |
| 15 | SHME Hasan Prishtina | 9,935.00 | 40,000.00 | 24.84% |
| 16 | SHMM Xheladin Deda | 5.00 | 2,000.00 | 0.25% |
| | **TOTALI** | **474,774.87** | **3,288,174.00** | **14.44%** |

*Tabela 1*

# 2. BUXHETI DHE SHPENZIMET

## 2.1 Shpalosja e Buxhetit

